| | |
|---|---|
| **MARRËVESHJE**<br>**(PËR REVOKIM KONTRATE SHITJE KUOTASH)** | **AGREEMENT**<br>**(FOR REVOKING THE SHARE PURCHASE CONTRACT)** |
| Sot më datë **09.09.2022,** nënshkruhet kjo "MARRËVESHJE PËR REVOKIM KONTRATE SHITJE KUOTASH" si më poshtë vijon: | Today on **09.09.2022,** it is hereby signed the present "Agreement for the revocation of THE SHARE PURCHASE CONTRACT" as follows: |
| **DISPOZITA PARAPRAKE:** | **PRELIMINARY PROVISIONS:** |
| **a.** Më datë **16.12.2019, z. Musa KASTRATI** në cilësinë e Shitësit dhe shoqëria e së drejtës tregtare Hollandeze **"ALINV B.V"** në cilësinë e Blerësit, kanë nënshkruar një kontratë për shitjen e 100% të kapitalit të shoqërisë "FULMER HOLDING" SHPK (NUIS L82028005T) *[Kontrata e shitjes së kuotave bashkëngjitur kësaj marrëveshje dhe pjesë integrale e kësaj të fundit];* | **a.** On **16.12.2019, Mr. Musa KASTRATI** in the quality of the Seller and the Dutch Company **"ALINV B.V"** in the quality of the Buyer, have signed a contract for the sale of 100% of the capital of the company "FULMER HOLDING" SHPK (NUIS L82028005T) *[The share purchase contract is attached to this agreement as an integral part of the latter];* |
| **b.** Në bazë të mirëkuptimeve e marrëveshjeve të mëparshme reciproke, palët vendosin me vullnet të lirë e të plotë, të nënshkruajnë këtë marrëveshje për revokimin e kontratës së shitjes së kuotave të datës 16.12.2019, si më poshtë vijon: | **b.** Based on the prior mutual understandings and agreements, the parties, based on their free and unconditioned will, hereby decide to sign this agreement for the revocation of the share purchase contract dated 16.12.2019, as follows: |
| **Neni 1**<br>**Palët në këtë Marrëveshje** | **Article 1**<br>**Parties to this Agreement** |
| **A. Z. Musa Kastrati,** Shtetas Shqiptar, lindur në Kukës, Shqipëri, më 28.12.1992, me pasaportë nr. SE1903623, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar. | **A. Mr. Musa Kastrati,** Albanian Citizen, born in Kukes, Albania, on 28.12.1992, with passport No. |

| | |
|---|---|
| **B. Alinv B.V,** një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit tregtar Holandez, me adresë të selisë qendrore: Strawinskylaan 1431, 1077XX, Amsterdam, The Netherlands, përfaqësuar nga **Dutch Trust Management B.V.** nga drejtori i saj Z. Nikita Vinogradov. | SE1903623, with full legal capacities to act.<br><br>**B. Alinv B.V,** a company founded under Dutch trade legislation, with headquarters at the address: Strawinskylaan 1431, 1077XX, Amsterdam, The Netherlands, represented by **Dutch Trust Management B.V.**, being represented by its director Mr. Nikita Vinogradov. |
| **Neni 2**<br>**Objekti i marrëveshjes**<br>2.1. Objekti i kësaj marrëveshje, është revokimi (shfuqizimi) i kontratës së shitjes së kuotave të datës 16.12.2019, nëpërmjet së cilës Shitësi (z. Musa Kastrati) transferoi nëpërmjet shitjes kundrejt Blerësit (ALINV B.V), **100% (njëqind përqind)** të kapitalit të shoqërisë "FULMER HOLDING" SHPK (NUIS L82028005T). | **Article 2**<br>**Object of the agreement**<br>2.1. Object of this agreement, it is the revocation (annulment) of the share purchase contract dated 16.12.2019, through which the Seller (Mr. Musa Kastrati) transferred through the sale to the Buyer (ALINV B.V), **100% (one hundred per cent)** of the capital of the company "FULMER HOLDING" (NUIS L82028005T). |
| **Neni 3**<br>**Pasojat e revokimit**<br>3.1. Me revokimin (shfuqizimin) e kontratës së shitjes së kuotave të datës 16.12.2019, palët kthehen në gjendjen e mëparshme, pra në gjendjen përpara transferimit të kuotave. Për të evituar çdo dykuptimësi, Shitësi (z. Musa Kastrati) ri-bëhet zotërues i 100% të kapitalit të shoqërisë "FULMER HOLDING" SHPK, duke zotëruar 1 (një) kuotë me vlerë nominale 100 lekë.<br>3.2. Nga ana tjetër, Bleresi (ALINV B.V), me nënshkrimin e kësaj marrëveshje revokimi, zhvishet nga pronësia mbi 100% të kapitalit të shoqërisë "FULMER HOLDING" SHPK, si dhe nga çdo e drejtë | **Article 3**<br>**Consequences of revocation**<br>3.1. With the revocation (annulment) of the share purchase contract dated 16.12.2019, the parties shall return to their previous situation, i.e. in the situation before the transfer of quotas. To avoid any misunderstanding, the Seller (Mr. Musa Kastrati) re-becomes the owner of 100% of the capital of the company "FULMER HOLDING" SHPK, with 1 (one) quota worth of 100 (one hundred) Albanian Leke.<br>3.2. On the other hand, the Buyer (ALINV B.V), with the signing of this |

| | |
|---|---|
| apo detyrim tjetër i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me zotërimin e mëparshëm të kuotës.<br><br>**Neni 4**<br>**Të drejta dhe detyrime të palëve**<br>4.1. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje revokimi, palët deklarojnë se nuk kanë dhe nuk do të kenë në të ardhmen, kundrejt njëra-tjetrës, asnjë detyrim apo pretendim të çdo lloj natyre, të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me kontratën për shitjen e kuotave të datës 16.12.2019.<br>4.2. Për këtë qëllim, Shitësi deklaron me përgjegjësi të plotë ligjore se nuk ka dhe nuk do të ketë ndër të tjera, asnjë pretendim për pagesë në lidhje me transferimin e kuotës, ashtu sikurse Blerësi zotohet që nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë pretendim të lidhur me pronësinë mbi kapitalin e shoqërisë "FULMER HOLDING" SHPK si dhe të drejta të tjera derivuese të tilla si por pa u kufizuar në: pjesëmarrje në fitime, dividendë, të ardhura të arkëtueshme etj.<br>4.3. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje revokimi, Shitësi (z. Musa Kastrati) ri-shndërrohet në pronar të vetëm dhe me të drejta ta plota të kuotës/kapitalit të shoqërisë "FULMER HOLDING" SHPK, ndërsa Blerësi (ALINV B.V) zhvishet nga çdo përgjegjësi vijuese e marrë përsipër në përputhje me kontratën e shitjes së kuotave të datës 16.12.2019.<br><br>**Neni 5**<br>**Gjuha e marrëveshjes dhe hyrja në** | revocation agreement, is definitely waving from the right of ownership on 100% of the capital of the company "FULMER HOLDING" SHPK, as well as from any other right or obligation directly or indirectly related to the previous possession of the quota.<br><br>**Article 4**<br>**Rights and obligations of the parties**<br>4.1. With the signing of the present revocation agreement, the parties declare that they do not have and shall not have in the future, against each other, any obligation or claim of any kind, directly or indirectly related to the share purchase contract dated 16.12.2019.<br><br>4.2. For this purpose, the Seller declares with full legal responsibility that there is not and will not be among other things, no claim for payment regarding the transfer of the quota, as the Buyer pledges and warrants that there is not and will not be any claim related to ownership rights over the capital of the company "FULMER HOLDING" SHPK as well as other deriving rights such as but without being limited to: participation in profits, dividends, income, etc.<br>4.3. With the signing of this revocation agreement, the Seller (Mr. Musa Kastrati) shall become again the Sole owner and with full quota/capital rights in the company "FULMER HOLDING" SHPK, while the Buyer (ALINV B.V) shall bear no subsequent liability previously taken over, in accordance with the share purchase contract dated 16.12.2019. |

| | |
|---|---|
| **fuqi** | **Article 5**<br>**Agreement's language and entry into force** |
| 5.1. Kjo marrëveshje përgatitet në 2 kopje në gjuhën Shqipe dhe Angleze, të dyja të njëvlershme dhe origjinale. Secila prej palëve në këtë marrëveshje do të marrë një kopje të saj. | 5.1. This agreement is prepared in 2 copies in Albanian and English language, both valid and original. Each of the parties to this agreement will receive a copy of it. |
| 5.2. Kjo marrëveshje hyn në fuqi dhe fillon efektet e saj menjëherë me nënshkrimin e saj prej palëve. | 5.2. This agreement comes into force and commences its effects immediately with its signature by the parties. |
| 5.3. Në rast mosmarrëveshjesh në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshje, palët do të bëjnë përpjekje maksimale për zgjidhje me mirëkuptim, në rast të kundërt, kompetente do të jetë Gj.Rr.Gj.Tiranë. | 5.3. In the event of disagreements or disputes over the interpretation or implementation of this agreement, the parties will make maximum efforts to find a solution based on mutual trust and understanding, otherwise the competent court to decide over the dispute shall be the Tirana District Court. |
| **Z. Musa Kastrati**<br>Musa Kastrati<br>FULMER HOLDING SH.P.K.<br>NIPT L82028005T | **Mr. Musa Kastrati**<br>Musa Kastrati<br>FULMER HOLDING SH.P.K.<br>NIPT L82028005T |
| **ALINV B.V** | **ALINV B.V** |
| **Nga: Dutch Trust Management BV**<br>**Përfaqësuar nga: Z. Nikita Vinogradov** | **By: Dutch Trust Management BV**<br>**Represented by: Mr. Nikita Vinogradov** |